



Data: 03.08.2018

Ref.: 863/180

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.9/2017, datë 02.08.2017), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 58-të, të mbajtur më 23 korrik 2018, mori:

## V E N D I M

- Hiqet masa e pezullimit për programin e studimit të BPrAL Kolegji "Dukagjini":
  - Banka, Financa dhe Kontabilitet, BSc, 180 ECTS.
- Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (tash e tutje UA për Akreditim), neni 21 dhe 26, pika 5.3.4, Agjencia e Kosovës për Akreditim (tash e tutje AKA) me datë 23 maj 2018 ka kërkuar nga të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (tash e tutje IAL) që ti dorëzojnë listat e stafit akademik për secilin program të studimit. Në afatin e përcaktuar nga AKA, BPrAL Kolegji "Dukagjini" ka dorëzuar listat e kërkuara nga AKA për programet e studimit.

Për programin e studimit, Ekonomi, Banka, Financa dhe Kontabilitet, BSc, 180 ECTS, pas vlerësimit të dokumentacionit të ofruar nga ky institucion për stafin akademik si bartës të këtij programi, KSHC vlerësoi që ky program ka staf akademik me gradën shkencore Dr.sc., dhe janë të fushës së programit të studimit, dhe mbi këtë bazë, KSHC bazuar në nenin 26, pika 5.3.4, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (tash e tutje LPPA) nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Dukagjini";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

*G. Luboteni*

Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

